

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT ¹

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

27.12.2023

Drejtuar: MAKE WITH ICT;Tirane Tirane TIRANE Rruga "Qemal Stafa", Pallati 31, Shkalla C, Kati III,
N. 39, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit; E hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-86926-11-09-2023

Objekti; Organizim klubet e ICT në shkolla,me afat, 6 muaj nga data e nënshkrimit te Kontratës
Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Trajnimi i nxënësve dhe mësuesve të shkollave të përfshira në
projekt do të realizohet pranë ambjenteve të shkollave dhe të Korça Innovation Hub. Gjatë
trajnitimit do të përfshihen 450 nxënës të grupmohave të ndryshme dhe 9 mësues TIK të këtyre
shkollave.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto
vlera përkatëse të ofruara:

1. FISA M12229001P
(Kontratë Bashkëpunimi me)

2. FIRST K82020002A
Vlera 3.670.000 (tre milion e gjashtëqind e shtatëdhjet mijë) lek pa tvsh

2. MAKE WITH ICT L82111037U
Vlera 3.870.000 (tre milion e tetëqind e shtatëdhjet mijë) lek pa tvsh

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

Skualifikohet O.E, FISA (kontratë bashkëpunimi me) FIRST për arsye se;

Asnjë nga anëtarët e bashkimit të shoqërive nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit , shtojca 8,kriteret e vecanta te kualifikimit,kapaciteti ekonomik, pika “ 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2021,2022, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. Kjo Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.”

Konkretisht asnje nga shoqëritë pjesetare te Bashkimit të operatoreve ekonomike nuk ka paraqitur vertetim per xhiron vjetore .

II-Bazuar ne Aktmarrëveshjen e Bashkëpunimit Nr 4624 Rep Nr1366 kol datë 24.11.2023 është krijuar Bashkimi i operatoreve ekonomike First sh.p.k dhe Fisa sh.p.k ku perfaqesues i ketij bashkimi eshte shoqëria Fisa sh.p.k.

Gjithashtu shoqëria Fisa sh.p.k ka dorëzuar ofertën në sistem duke specifikuar pjesëmarrjen si bashkim operatorësh.

Për sa më sipër ky bashkim operatorësh duhet të përmbushë kriteret sipas përcaktimeve të bëra në nenin 88 pika 3 dhe 4 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 si më poshtë vijon:

Neni 88

Bashkimi i operatorëve ekonomikë

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

4. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh rezulton se :

1-Shoqëria Fisa sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për vertetimin e shërbimeve të mëparshme të ngjashme,pra nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit , shtojca 8,kriteret e vecanta te kualifikimit,pika 2.3.1.

2-Shtojca 9–“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” i paraqitur nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk është plotësuar saktë . Në kushtet kur ofertuesi ka marrë pjesë dhe ka ofertuar si bashkim operatorësh në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të ishte evidentuar ky fakt.

Ndërkohë që në formularët përmbledhës të vetëdeklarimit shoqëria First sh.p.k është deklaruar si subjekt mbështetës dhe gjithashtu në pjesën “ B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura” është duhet të ishte përzgjedhur pika 6 b dhe jo pika 6 a .

Në rastin konkret shoqëria First sh.p.k është deklaruar në formularin përmbledhes të vetëdeklarimit si subjekt mbështetës ndërkohë që në të gjitha dokumentat e tjera rezulton se kjo shoqëri është anëtar i bashkimit të operatoreve ekonomike.

Edhe në rast se shoqëria First sh.p.k do të konsiderohej subjekt mbështetës sipas përcaktimeve të bëra në nenin 90 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 sërisht nuk plotësohen kriteret e kualifikimit për arsye se në 90 pika 2 të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 përcaktohet se “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”.

Në këtë rast shoqëria Fisa sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion për punët e ngjashme dhe as vërtetim për xhiron vjetore.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë MAKE WITH ICT; Tirane Tirane TIRANE Rruga "Qemal Stafa", Pallati 31, Shkalla C, Kati III, N. 39, Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3.870.000 (tre milion e tetëqind e shtatëdhjet mijë) lek pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*Ndmermarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes adresa ; rruga “Dhimitër Denasi”*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]

Ylli Musaka